

VENDIM
Nr. 17, datë 4.7.2012

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LEZHË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për efekt të mbarimit të afatit operatorit sh.a ujësjellës-kanalizime Lezhë me:

Drejtues ligjor: z. Zef Gjergj Maçi

Drejtues teknik: z. Petrit Ded Bardhi

2. Operatori sh.a UK Lezhë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Lezhë, fshati Ishull Lezhë, Ishull Shëngjin.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datë 3.7.2016.

KRYETARI
Avni Dervishi